



REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery		21. 07. 2023	3 viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shërbim Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHUK	5325/2023		119



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.831/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtës, sipas ankesës me numër A.nr. 831/2023 të datës 09.06.2023 të parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 16 paragrafi 3, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 20.07.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.831/2023 e datës 09.06.2023 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Nëpunësja civile e punësuar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transferove, më datë 09.06.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.831/2023, për shkak të mos pagesës së pagave jubilarë nga organi i punësimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje vetëm Këshilli) bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 12.06.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses të organi i punësimit, ndërsa ky i fundit më datë 13.06.2023, ka

dërguar përgjigje në ankesë së bashkoju me shkresat ndërlidhur me këtë çështje juridiko - administrative.

**Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 4651/2023 të datës 09.06.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën për pagën jubilarë nr.3773 të datës 05.10.2022 nga ankuesja për Udhëheqësin e Administratës Pensionale /Regjioni i Prizrenit; Kërkesën për pagën jubilarë të datës 02.06.2022 me nr.1815 nga ankuesja për Udhëheqësin e Administratës Pensionale/Regjioni i Prizrenit; kopja e letërnjoftimit të nakueses; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 12.06.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 13.06.2023 nga organi i punësimit bashkë me shkresat e lëndës; Akt emërimi me nr.160 i datës 08.02.2012; Lista e pagave e muajit dhjetor 2022 ku dëshmohet se ankueses i është kompensuar paga jubilarë në shumën 97.00 euro; Kërkesa për pagesë retroaktive e datës 01.12.2022; Vërtetim i datës 13.06.2023 mbi përvojën e punës dhe Lista e pagave për muajin gusht 2017 me të cilën dëshmohet se ankueses i u është kompensuar paga jubilarë në shumën prej 93.50 euro.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit *është e pabazuar, sepse:*

Nga shqyrtimi i provave të administruara rrjedh se ankuesja që nga data 01.11.2000 është e punësuar në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve dhe se e njëjta që nga kjo datë ushtron pozitën e punës Nëpunëse e Pensioneve dhe Benificioneve në Zyrën e Pensioneve, Zyra Regjionale në Prizren.

Tu je sipas provave të kësaj çështje rezulton, se ankuesja me data 09.06.2022 dhe atë 05.10.2022, kishte parashtruar kërkesë të organi i punësimit lidhur me pagesën e dy pagave jubilarë, me arsyetimin se ankuesja kishte 20 vite përvojë pune dhe se asnjëherë nuk i është bërë ndonjë pagesë jubilarë. Ndërsa nga shkresat e lëndës nuk vërtetohet fakti së organi i punësimit kishte dhënë për ankuesen ndonjë përgjigje në kuptim të kërkesave të datës 09.06.2022 dhe datë 05.10.2022.

Ankuesja me datë 09.06.2023 parashtron ankesë në Këshilli për shkak të mos pagesës se pagave jubilarë me pretendimin së organi i punësimit në kundërshtim me Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës të datës 18.03.2014 neni 52, nuk kishte paguar ankueses shërbimin jubilar lidhur me 10 dhe 20 vitet e përvojës së punës. Kërkon që Këshilli të aprovoj ankesën si të bazuar dhe ankuesit ti njoh të drejtën e pagesës së dy shpërblimeve jubilarë.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankueses, Kolegji ka shqyrtuar bazën ligjore mbi të cilën janë ngritur pretendimet ankimore të ankueses dhe si rrjedhojë ka konstatuar së Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës (MPKK) e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.38/2014 të datës 18.06.2014 ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 dhe e njëjta sipas nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, ka qenë e zbatueshme në periudhe jo me shumë se tri (3) vjet, respektivisht deri me datë 31.12.2017. Kolegji po ashtu ka konstatuar se Oda Ekonomike e Kosovës si Partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social, dhe njëherit nënshkruese e MPKK-së, me datë 15.09.2017 është tërhequr nga zbatimi i MPKK-së, dhe rrjedhimisht ka pamundësuar zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive pas datës 31.12.2017, andaj mbi këtë bazë rrjedh se pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuar, ngase sipas vërtetimit të datës 10.6.2023 të Udhëheqësit të Personelit të MFPT

konstatohet se ankuesja është e punësuar në këtë institucion publik që nga data 01.11.2000, kështu që nisur nga ky fakt rrjedhë së ankuesja 10 vjetorin e përvojës së punës e ka arritur me data 01.11.2010 në kohën ku nuk ka qenë në fuqi Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, ndërsa 20 vjetorin e përvojës së punës e ka arrit me datë 01.11.2020 pra edhe në këtë periudhë nuk ka qenë në fuqi në Marrëveshje e Përgjithshme Kolektive, kështu që edhe ankuesja nuk ka fituar të drejtin në kompensim të shpërblimit jubilar sipas nenit 52 të kësaj marrëveshje e cila përcaktonte se: *I punësuari, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë: 1.1.për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page mujore të tij; 1.2.për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij; 1.3.për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij. 2.Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë. 3.Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf.*

Ndërlidhur me konstatimin si me sipër Kolegji mori parasysh edhe mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të datës 27.02.2023, me te cilin është theksuar se: *...I Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive Kosovës e lidhur më datë 18.03.2014, dhe nënshkruar nga Organizatat e punëdhënësve (Oda Ekonomike e Kosovës dhe Aleanca Kosovare e Biznesit), Organizatat e të punësuarve (Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës), si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale), (në tekstin e më tejme: Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës) aplikohet në periudhën kohore nga data 01.1.2015-31.12.2017.....VI. I punësuari në bazë të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, ka të drejtë në shpërblimin jubilar siç përcaktohet me nenin 52, të kësaj marrëveshje, nëse plotësohen këto kushte dhe atë: a) që viti jubilar i punësimit për 10, 20 dhe 30 vjet të arrihet në kohën kur kjo marrëveshje aplikohet si në pikën II, të këtij mendimi juridik, dhe b) përvoja e punës për 10, 20 dhe 30 vjet duhet të jetë e pandërprerë të punëdhënësi i fundit... Arsyetimi për pikën II (dy) të mendimit juridik - Sa i përket pikës II (dy) të këtij mendimi juridik, duke qenë se bëhet fjalë për zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, për periudhën kohore që duhet të aplikohet marrëveshja e përgjithshme kolektive, lidhur me marrëdhëniet juridiko-civile të cilat kanë lindur nga data 01.01.2015, e tutje, Gjykata Supreme e Kosovës thekson se kjo marrëveshje aplikohet në periudhën kohore nga data 01.1.2015 31.12.2017..... Qëndrimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, parimisht e mbështet konceptin se edhe për kërkesat për shpërblim jubilar, zbatohen dispozitat e marrëveshjes e cila ka qenë në fuqi në kohën kur është lindur marrëdhënia juridiko-civile, në qoftë se çështja kontestuese është gjykuar dhe vendosur nga ana e gjykatës deri sa ka qenë në fuqi ajo marrëveshje.*

Nisur nga konstatimet si me sipër, rezulton së ankuesja me status të nëpunësit civil ka zotëruar vetëm të drejtën e kompensimit të shpërblimit të përvjetorit (jubile) në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë. Përkatësisht Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë (i aplikueshëm nga data 10.07.2010 deri me 04.02.2023) me nenin 22 paragrafi 2 nën paragrafi 2.3 përcaktonte se: *"Nëpunësit civilë, kanë të drejtat në vijim: shpërblimi i përvjetorit (jubile)",* ndërsa Rregulloreje Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë, ka paraparë se: *"Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësve civilë, të cilët janë në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Shërbimin Civil iu takon një shpërblim në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil pas çdo dhjetë (10) vjetësh pune".* Mbi këtë përcaktim ligjor, Kolegji nga shkresat e lëndës ka konstatuar se organi i punësimit edhe pse jo me afat kishte bërë kompensimin e shpërblimit jubilar për ankuesen dhe atë në gusht të vitit 2017 në shumën prej 93.50 euro dhe dhjetor 2022 në shumën prej 97.00 euro, andaj mbi bazën e këtyre konstatimeve Kolegji në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragraf 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për




Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËSF PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda A.nr.831/2023

Avdyl BEKTESHI

  
Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

  
Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Udhëheqësit të Njesisë të Burimeve Njerëzore në MFPT dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

